REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA GLLOGOC
GLLOGOC MUNICIPALITY
PRANUAR 30/10/2026
Nj. Org. | Numër | Shtojca | Vlera
01- 060/04-46854

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Opština Drenas –Municipality of Drenas

Data/Date: 30.10.2026

Nga/Od/From: Njësia për të Drejta të Njeriut dhe Barazi Gjinore

Për/Za/To: Zyrën për Komunikim me Publikun

Tema/Subjekat/Subject: Konsultimi publik **për Draft Planin Lokal të veprimit per barazi gjinore 2027 – 2029**
u mbajt me datë 30.10.2026 në Sallën e Kuvendit të Komunës, dhe filloi në ora 11:00.

P R O C E S V E R B A L

Konsultimi publik **për Draft Planin Lokal të veprimit per barazi gjinore 2027 – 2029**

Informatë rreth njoftimit:

Duke u bazuar në Ligjin Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës së Drenasit 01 Nr.110-6904 dhe nenin 19 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna, Komuna e Drenasit ka bërë njoftimin publik për hapjen e konsultimit publik për dokumentin, ku është publikuar ne të gjitha platformat.

Në bazë të Njoftimi per konsultim publik per Draft Planin Lokal te Veprimit per Barazi Gjinore 2026-2029 me numër 01-070/03-43679 datë 15/10/2026 eshte publikuar ne te gjitha platformat, ashtu sic kerkohet me udhezim administrative, ndersa data e mbajtes se konsultimit do te jete me 30.10.2026 ne ora 11:00 ne Sallen e Kuvendit.

Me poshte gjeni linqet e publikimit te njoftimit dhe draft-planit.

Ueb faqja ku eshte publikuar njoftimi dhe draft plani; https://gllogoc.rks-gov.net/konsultimet-publike/

Platforma e konsultimeve publike ku eshte publikuar draft plani; https://konsultimet.rks-gov.net/consultationsList.php

Dhe rrjeti social Facebook I Komunes; https://www.facebook.com/komunadrenas/

Të gjitha të drejtat e rezervuara

P R O C E S V E R B A L

Vendi i takimit	Data	Ora
Salla e Kuvendit, Komuna e Drenasit	**E Premte, 30 Tetor 2026**	**11:00**

Takimin lidhur me degjimin publik **Draft Planin Lokal të veprimit per barazi gjinore 2027 – 2029** e hapi z. **Bekim Dobra**, i cili fillimisht i falënderoi të gjithë të pranishmit për pjesëmarrjen në diskutimin publik për Draft Planin Lokal të Veprimit për Barazi Gjinore 2027–2029.

Në veçanti, z. Dobra falënderoi znj. **Zahrie Podrimqaku Subashi**, kryesuese e Grupit Punues për hartimin e këtij dokumenti, për angazhimin dhe kontributin e dhënë gjatë procesit të hartimit.Z. Dobra theksoi se pjesëmarrja në takimin e sotëm është relativisht e vogël që mund të kontribuojnë me mendime dhe sugjerime. Megjithatë, ai sqaroi se të gjithë qytetarëve dhe palëve të interesuara u është dhënë mundësia që dokumentin ta shqyrtojnë dhe të japin komentet e tyre në mënyrë elektronike.Ai theksoi se Draft Plani është hartuar duke u bazuar në kërkesat dhe nevojat e identifikuara gjatë procesit të hartimit, me synim që dokumenti të jetë sa më gjithëpërfshirës dhe i harmonizuar me legjislacionin dhe rregullat në fuqi në Republikën e Kosovës.Ai sqaroi se procesi i konsultimit publik është zhvilluar në përputhje me kërkesat e **Udhëzimit Administrativ**, ku parashihet që njoftimi për konsultim publik të jetë i hapur për së paku 15 ditë dhe që drafti të publikohet në uebfaqen zyrtare të komunës, duke u mundësuar qytetarëve dhe palëve të interesuara të japin komente dhe sugjerime.

U sqarua se konsultimi publik nuk përfundon me mbajtjen e takimit të sotëm. Qytetarët dhe palët e interesuara kanë edhe **4 ditë në dispozicion, deri më 04.11.2026**, për të paraqitur komentet dhe sugjerimet e tyre përmes adresave elektronike të publikuara, si dhe në formë fizike pranë administratës komunale.

Z. Dobra ftoi të gjithë të interesuarit që ta shfrytëzojnë këtë mundësi dhe të kontribuojnë në finalizimin e dokumentit.Ai sqaroi gjithashtu se dokumenti është hartuar me mbështetjen e një eksperteje të angazhuar nga Zyra për Barazi Gjinore dhe se znj. Zahrie Podrimqaku Subashi është kujdesur për koordinimin e procesit dhe angazhimin e ekspertizës së nevojshme.Në fund të fjalës së tij, z. Dobra i inkurajoi të gjithë, zyrtaret komunale, që ta lexojnë dokumentin me kujdes

Të gjitha të drejtat e rezervuara

dhe, nëse kanë komente apo propozime, t'i përcjellin ato te znj. Zahrie Podrimqaku Subashi, në cilësinë e kryesuese së Grupit Punues, në mënyrë që dokumenti të jetë sa më gjithëpërfshirës.

Fjala iu dha znj. **Zahrie Podrimqaku Subashi**, kryesuese e Grupit Punues, e cila i përshëndeti të gjithë pjesëmarrësit në diskutimin publik.Ajo theksoi se objektivi kryesor i këtij takimi është marrja e mendimeve, sugjerimeve dhe komenteve nga pjesëmarrësit lidhur me Draft Planin Lokal të Veprimit për Barazi Gjinore 2027–2029.Znj. Podrimqaku Subashi theksoi se dokumenti do të shërbejë si dokument pune për **Komunën e Drenasit**, drejtoritë komunale dhe sektorët e ndryshëm, me qëllim të promovimit dhe avancimit të barazisë gjinore. Ajo tha se gjatë procesit janë organizuar konsultime paraprake me palë të ndryshme, të cilat kanë kontribuar në mbledhjen e informatave themelore dhe në përgatitjen e procesit të hartimit të Planit Lokal të Veprimit.

Znj. Podrimqaku Subashi bëri të ditur se staf mbështetës të ekipit për përpilimin e planit ka qenë edhe ekspertja nga **Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT)**, Prof. **Jorida Xhafaj**, e cila ka ofruar mbështetje në mënyrë vullnetare.Në fund, znj. Podrimqaku Subashi theksoi se komentet mund të paraqiten drejtpërdrejt gjatë konsultimit, përmes adresave elektronike të publikuara, si dhe duke u paraqitur në zyrën e saj.

Fjalën e mori z. **Afrim Prokshi**, i cili falënderoi Grupin Punues dhe ekipin e hartimit për punën e bërë dhe për angazhimin gjatë përgatitjes së dokumentit.Nga këndvështrimi i koordinatorit dhe duke marrë parasysh kërkesat që lidhen me Grantin e Performancës, z. Prokshi propozoi që në dokument të bëhen disa ndryshime dhe plotësime.Ai theksoi se fillimisht duhet të rishikohet pjesa e **demografisë**, veçanërisht:

- numri i ekonomive familjare;
- numri i pensionistëve;
- numri i personave të papunë.

Lidhur me faqen 25 dhe objektivat e përcaktuara në dokument, z. Prokshi propozoi që vlerat dhe objektivat të rishikohen dhe, aty ku është e nevojshme, të zhvendosen në vitin **2027**, duke marrë parasysh se viti 2026 është në përfundim.Ai gjithashtu propozoi që në tabelën përfundimtare të dokumentit të ndahen në kolona të veçanta **rezultatet dhe indikatorët**.

Të gjitha të drejtat e rezervuara

Z. **Bekim Dobra** e vlerësoi si të qëlluar komentin e z. Prokshi, veçanërisht sa i përket rishikimit të pjesës së buxhetit.Ai theksoi se, duke qenë se viti 2026 është në përfundim, aktivitetet duhet të planifikohen në mënyrë që të jenë realisht të zbatueshme gjatë periudhës së planit.

Fjalën e mori z. **Hazir Elshani**, i cili sqaroi se gjatë përgatitjes së dokumentit është bërë përpjekje që kostot e aktiviteteve të jenë minimale dhe reale, duke shmangur paraqitjen e çmimeve të larta.

Z. Bekim Dobra kërkoi edhe nga **Drejtorisë së Kulturës** që të japin komentet duke marrë parasysh se kjo drejtori është e përfshirë në **12 aktivitete** të parapara në plan.

Fjalën e mori z. **Ekrem Franca**, i cili sqaroi se në aktivitetet e planifikuara është marrë parasysh përfshirja e të dy gjinive, përkatësisht janë paraparë aktivitete për femrat dhe meshkujt.

Në përfundim të takimit, z. **Bekim Dobra** i falënderoi të gjithë pjesëmarrësit për kontributin dhe komentet e dhëna.Ai i inkurajoi të gjithë drejtorët, zyrtarët dhe pjesëmarrësit që ta lexojnë edhe një herë me kujdes Draft Planin Lokal të Veprimit për Barazi Gjinore 2027–2029.

U theksua se komentet dhe sugjerimet mund të dërgohen edhe pas takimit, deri më **04.11.2026**, përmes adresave elektronike të publikuara ose në mënyrë fizike pranë administratës komunale.

Të gjitha të drejtat e rezervuara

Njoftimi per diskutim publik

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Opština Drenas-Municipality of Drenas
01 Nr. 070/03-43679 datë 15/10/2026

Duke u bazuar ne Ligjin Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Statutit të Komunës së Drenasit (Gllogocit), 01 Nr.110-6904 dhe Nenit 19 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të Hapur në Komunë, Komuna e Drenasit/Gllogocit lëshon këtë:

N J O F T I M PËR KONSULTIM P U B L I K

Lidhur me organizimin e konsultimit publik me qytetarë për Draft – Plani Lokal i Veprimit për Barazi Gjinore 2026-2029

Ky dokument do të jetë në konsultim publik nga data **15.10.2026** deri me datën **04.11.2026**, ndërsa konsultimi publik me qytetarë do të mbahet me datë **30.10.2026** në Sallën e Kuvendit të Komunës duke filluar nga ora **11:00**.

Komentet dhe sugjerimet tuaja, mund t'i dërgoni deri më datë **04.11.2026** në ora **16:00** në këto adresa; komuna.drenas@rks-gov.net ose zahrie.podrimqaku@rks-gov.net

Për më shumë detaje në lidhje me Draft – Planin Lokal të Veprimit për Barazi Gjinore 2026-2029 vizitoni linqet e mëposhtme ku është publikuar ky draft dokument;

Ueb faqja zyrtare e Komunës në rubrikën Konsultimet Publike, në këtë link:

Platforma për Konsultime Publike:

https://gllogoc.rks-gov.net/konsultimet-publike/

https://konsultimet.rks-gov.net/consultationsList.php

Rrjetin social të Facebook:

https://www.facebook.com/komunadrenas

Bekim Dobra

Udhëheqës i Zyrës për Komunikim me Publikun

Të gjitha të drejtat e rezervuara

Lista e pjesëmarresve

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Opština Drenas-Municipality of Drenas

Lista e pjesëmarrësve në Konsultimin Publik për Draft-Planin Lokal të Veprimit për Barazi Gjinore në Komunën e Drenasit (Gllogocit) 2026-2029. Data e mbajtjes së konsultimit: 30.10.2026

Nr.	Emri	Mbiemri	Gjinia M F	Nënshkrimi
1.	Zahrit	[illegible]	F	[illegible]
2.	Bekim	Dobra	M	[illegible]
3.	Floriana	Hasi	F	[illegible]
4.	Rendresë	XHEMA	F	[illegible]
5.	Sadete	Zariqi	F	[illegible]
6.	Nexhmedin	Gruda	M	[illegible]
7.	Kaltrina	Qerkinaj	F	[illegible]
8.	Afrim	Prolshi	M	[illegible]
9.	Lirie Fuzlia	Fuzlia	F	[illegible]
10.	LIRIDONA Bersha	Dobra	F	[illegible]
11.	Lindore Ka	Kastrati	F	[illegible]
12.	Hasime [illegible]	Gashi	F	[illegible]
13.	ARMEND	KURTAJ	M	[illegible]
14.	BASRI	GASHANI	M	[illegible]
15.	EKREM	FRANCA	M	[illegible]
16.	ANTIGONA	DURMISHI	F	[illegible]
17.	[illegible]	[illegible]	M	[illegible]
18.	Kaltrina	Dvorani	F	[illegible]
19.	FATLINDA	ZYMBERI	F	Zymberi
20.	Bislime	Dvorani	F	[illegible]
21.	Arbesa	Dobra	F	[illegible]
22.	Fidaie	Morina	F	[illegible]
23.	Indire	Olluri Thaci	F	[illegible]
24.	Hazir	Elshani	M	[illegible]
25.				
26.				

* *Në këtë takim, përveç kësaj liste, do të bëhen fotografi dhe, me nënshkrimin tuaj, pajtohent që fotografitë dhe kjo listë të përdoren për komunikim zyrtar.*

Pjesëmarrës në konsultimin publik ishin 24 pjesëmarrës, prej tyre 16 Femra dhe 8 Meshkuj.

Të gjitha të drejtat e rezervuara

Foto nga konsultimi publik





Të gjitha të drejtat e rezervuara





Të gjitha të drejtat e rezervuara





Të gjitha të drejtat e rezervuara



Procesmbajtëse:

Procesverbali është përgatitur nga:

Zahrie Podrimqaku-Subashi
KNJDNJ dhe BGJ

Monitoruar nga Bekim Dobra

Udhëheqës i Zyrës Komunikim me Publikun

Të gjitha të drejtat e rezervuara